

PROCESVERBAL
nga seanca e 33-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 20.08.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski, dr. Metodija Jançeski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë, ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Maja Damevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Z. Petrushevski hapi seancën e 33-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:05 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri me 6 vota „pro“, miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 10-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 07.08.2024.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 32-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 07.08.2024.
3. Propozim-vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar.
4. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e seancës së 10-të publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 07.08.2024, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e seancës së 32-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 07.08.2024, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Z. Trajçevski arsyetoi Propozim-vendimin për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar. Shpjegoi se më 6 gusht të këtij viti, Këshilli i Agjencisë ka inicuar procedurë për heqjen e lejes për transmetuesin në fjalë, pasi që nuk ka përmbushur detyrimet nga neni 15 paragrafi (1) të Ligjit për Media, gjegjësisht nuk ka dorëzuar të dhënat për strukturën e pronësisë, redaktorin përgjegjës/redaktorët, burimet e financave në vitin 2023, të ardhurat dhe shpenzimet në total të realizuara nga veprimtaria e kryer në vitin 2023 dhe dëgjueshmërisë mesatare në vitin 2023. Në këtë drejtim propozoi që Vendimin për heqjen e lejes që Këshilli do ta miraton të jetë me kusht, pra të presim dy-tre ditë për t'i dhënë mundësinë që RA PRO-FM të paraqesë të dhënat e nevojshme, në të kundërtën nëse nuk i dorëzon, pas skadimit të këtyre ditëve kryetari i Këshillit duhet ta nënshkruajë Vendimin i cili do të botohet në Gazetën Zyrtare të RMV-së. Nëse të premtën i dorëzon të dhënat e nevojshme, do të caktohet seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë dhe do të propozohet Vendim për anulimin e vendimit për heqjen e lejes që Këshilli do ta miratojë në këtë seancë.

Z. Petrushevski deklaroi se pajtohet me propozimin e drejtorit, para së gjithash për shkak se Këshilli i Agjencisë mban qëndrim të njëjtë ndaj të gjitha mediave. Me këtë propozim do t'i ndihmohet radios, edhe pse arsyeja që çoi në heqjen e lejes është e pakuptueshme. Këshilli në pajtim me Ligjin do të votojë për heqjen e lejes, por do t'i jepet mundësia që për dy ditë të dorëzon dokumentacionin e nevojshëm.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, për shkak se pas dhënies së lejes ndodhën situata që paraqesin pengesa Ligjore për zotëruesin e lejes për kryerjen e veprimtarisë, gjegjësisht për shkak se edhe në afatin plotësues nuk ka përmbushur detyrimet ligjore dhe drejtuar Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nuk ka dorëzuar të dhëna për strukturën e pronësisë, redaktorin përgjegjës/kryredaktorët, burimet e financave në vitin 2023, të ardhurat dhe shpenzimet në total të realizuara nga veprimtaria e kryer në vitin 2023 dhe dëgjueshmërisë mesatare në vitin 2023.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lartpërmendur ta boton në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, dhe në ueb-faqen e Agjencisë dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pika 4

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**